



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

RAPORT
PËR
REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK
TË
PROJEKTVENDIMIT “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
SEKTORIALE TË TRANSPORTIT DHE PLANIT TË SAJ TË
VEPRIMIT 2030”

1. Titulli i projekt aktit/dokumentit

Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të saj të Veprimit 2030”.

Ky projektvendim ka për qëllim miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të saj të Veprimit 2030, si dokumenti kryesor që përcakton drejtimin e zhvillimit të sektorit në përputhje me prioritetet kombëtare dhe procesin e integrimit evropian.

Strategjia synon zhvillimin e një sistemi transporti modern, të sigurt dhe të qëndrueshëm, që përmirëson lidhshmërinë, rrit eficiencën ekonomike dhe garanton akses më të mirë për qytetarët dhe bizneset, në linjë me vizionin e Bashkimit Evropian.

Objektivat kryesore të Strategjisë janë:

- përafrimi me acquis të BE-së dhe zbatimi efektiv i tyre;
- zhvillimi i infrastrukturës dhe integrimi me rrjetin TEN-T;
- promovimi i lëvizshmërisë së sigurt, të qëndrueshme, inteligjente dhe multi modale;
- rritja e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve;
- forcimi i kapaciteteve institucionale dhe koordinimit.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Ky projektvendim është publikuar në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel ekspertit dhe qytetari) në datë 16 Prill 2026 deri në 14 Maj 2026, për një periudhë 20 ditë pune, në respektim të afatit ligjor të konsultimit.

Linku në RENJKP:

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/962>

3. Metodat e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre.

Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të saj të Veprimit 2030”, u konsultua:

1. Nëpërmjet publikimit në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nga data 16 Prill 2026 deri në 14 Maj 2026;
2. Nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nga data 16 Prill 2026 deri në 14 Maj 2026;
3. Ndërmjet postës elektronike të koordinatorit për njoftim dhe konsultim publik: vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Plan i Veprimit 2030 është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me institucionet dhe agjencitë e sektorit të transportit pjesë e planit të veprimit të kësaj Strategjie, me mbështetje teknike nga konsulenca e kontraktuar nga Sekretariati i Komunitetit të Transportit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën; Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato; Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të saj të Veprimit 2030” ka pasur 332 lexime dhe 6 (gjashtë) komente, të cilat janë refuzuar me arsyetimin si më poshtë:

- për komentin e parë: pjesa e parë e komentit bie ndesh me procedurat/afatet e ndjekura nga institucionet e Bashkimit Europian në kuadër të Acquis që po transpozohet, ndërsa pjesa e dytë e komentit lidhet me ndërhyrje jashtë kompetencës së institucioneve të qeverisjes qendrore.
- 5 (pesë) komentet e tjera gjejnë zgjidhje në një projektakt tjetër ligjor/nënligjor.

Pasqyra e komenteve dhe arsyetimi për secilin koment pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/ I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi

1.	Të pergjithsh me	1. Strategjia është perqendruar kryesisht ne problemet e integritit me EU te cilat natyrisht qe do te ndihmojne ne permiresimin e cilesise se sherbimeve te transportit te qytetareve shqiptare, por ka edhe probleme qe kane te bejne me legjislacionin vendas ne fuqi apo me menaxhimin psh. jo vetem te rrugeve kombetare por edhe atyre lokale.	Ekspert i fushës	I refuzuar	Legjislacioni është trajtuar gjerë në strategji. Përafrimi i legjislacionit vendas me atë të BE-së, përbën një prioritet strategjik më vehte. Përsa i përket rrugëve lokale, ato janë në administrimin e Pushtetit Vendor.
		2. Kodi Rrugor është legjislacioni kryesor qe rregullon marrëdhëniet midis aktoreve që menaxhojne rrjetin. Ky kod është Kodi Italian i vitit 1990. Këtij kod i		I refuzuar	Strategjia Kombëtare për Sigurinë Rrugore 2026-2030 përmban aktivitete/masa që janë prioritzuar me efekte në arritjen e objektivave të përcaktuara. Në këtë aspekt nuk është identifikuar rishikim i zgjeruar i Kodit Rrugor, si pjesë e këtyre masave. Për më tepër që është

	janë bërë amendime të herëpashërës hme. Mos ndoshta duhet rishikur?		përgatitur si dokument politikash më vete Strategjia e Sigurisë Rrugore. Qasja ndaj këtij propozimi duhet të ketë sqarime të konsiderueshme mbi nevojën dhe defektet e realizuara në lidhje me Kodin aktual Rrugor dhe se një rishikim i plotë kërkon angazhimin ndërsektorial me kapacitete njerezore dhe administrative të cilat aktualisht janë të munguara.
	3. Rrjeti TEN-T në Shqipëri përbën rrjetin kryesor. Deri me sot asnjë nga seksionet rrugore kombëtare nuk konsiderohet E-Road. Shqipëria ka nenshkruar AGR por ne dallim te vendeve te rajonit ne nuk kemi asnjë E-Road te certifikuar. Une mendoj që certifikimi	I refuzuar	Rrjeti TEN-T si edhe rrjeti kombëtar nën administrimin e MIE ndërtohen dhe mirëmbahen sipas standarteve të miratuara. Së fundmi me Urdhrin e Ministrit nr. 152, datë 02.07.2026, është miratuar zbatimi i Rregullores “Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit trans-Evropian të transportit”. Ky urdhër përafron plotësisht Rregulloren TEN-T (BE) 2024/1679.

	do te na beje qe te jemi me te kujdeshem me ndertimin e rrjetit ne perputhje me standartet e AGR		
	4. Në dokument kerkohet qe per mirembajtje te kete buxhet te dedikuar. Ne kete pike Ministria e Financave ka qene kunder. Do te ishte mire qe te kishte nje buxhet të tillë ndërsa mirëmbajtja me kontraktim sic përmendet në dokument nuk do te thotë që të jete dhe ne te ardhmen. Deri më sot nuk ka një dokument që te shpjegoje efektivitetin apo nivelin e sherbimit si pasoje e mirembajtes	I refuzuar	Buxheti i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor kombëtar, është buxhet i dedikuar, i planifikuar vetëm për këtë shërbim. Shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor kombëtar, që administrohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, realizohet nëpërmjet kontratave të veçanta për rrjetin primar (4 kontrata të mëdha) dhe rrjetin sekondar me kontrata të vogla sipas rajoneve. Gjithashtu, sqarojmë se legjislacioni aktual që lidhet me planifikimin buxhetor nuk përmban dispozita të posaçme për krijimin e fondeve të dedikuara.

		me kontraktim			
		5. Lidhur me SUMP mendoj që se pari duhet të përcaktohet me ligj hartimi i tyre si plane strategjike nga Bashkitë me një numër të caktuar popullsie. (Eshtë vendosur kjo ne strategji, Masa: 1. Krijimi i një Kuadri Kombëtar Rregullator dhe Institucional për SUMP • Vendosja e dispozitave ligjore që parashikojnë hartimin dhe miratimin e Planeve të Qëndrueshme të Lëvizshmërisë Urbane (SUMP) deri në vitin 2030 nga të gjitha bashkitë kryesore (me popullsi mbi	I pranuar pjesërisht	Udhëzimi nr. 5167, datë 26.12.2002 "Mbi organizimin e qarkullimit dhe sinjalizimit rrugor" përcakton norma për planifikimin e trafikut. Manualët e vlerësimit dhe planifikimit të trafikut si për akset nacionale ashtu dhe ato të bashkive që propozoni do të merren parasysh kur të hartohen manualët e hartimit të SUMP.	

		50 000 banorë ose qendra rajonale), si dhe nga të gjitha nyjet urbane të rrjetit TEN-T. Ne dokument theksohet që Bashkitë duhet të përcaktojnë dispozitat për hartimin e SUMP. Nga ana tjetër SUMP është plan strategjik dhe për implementim in e tij kërkohet të hartohen plane të detajuar të menaxhimit të trafikut. Aktualisht në Shqipëri nuk ka dokumente ose standarte lidhur me planifikimin dhe vlerësimin e trafikut si për akset kombëtare ashtu dhe ato të qyteteve. Unë do të sygjeroja që			
--	--	--	--	--	--

		bashkë me hartimin e dokumenteve të SUMP të hartohen manualët e vleresimit dhe planifikimit të trafikut si për akset nacionale ashtu dhe ato të bashkive. Sot po hasim probleme të trafikut dhe bllokime të shumta në të gjithë rrjetet rrugore.			
		6. ITS është një nga drejtimet që do të zhvillohet në të ardhmen. Me qëllim koordinimin e sistemeve do të sygjeroja që të përgatiteshin standartet e ITS të cilat do të bëjnë të mundur koordinimin e ITS në rrjetin rrugor me ato të Bashkive.		I refuzuar	Ekziston Strategjia e Sistemeve Inteligjente për transportin rrugor. Strategjia Sektoriale e Transportit 2030 përmban Objektivin 3.2 "Zbatimi i Sistemeve Inteligjente të Transportit (SIT), biletimit digjital, sistemeve elektronike të tarifimit (e-tolling) (kur është e aplikueshme), si dhe i menaxhimit inteligjent të trafikut në gjithë rrjetin TEN-T"

		Sistemet e deritanishme te ITS nuk kanë funksionuar dhe ndoshta një nga arsyet përvec menaxhimit është dhe hartimi i dokumenteve bazë.			
--	--	---	--	--	--